



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E DREJTËSISE
Ministri

U R D H Ë R

Nr. 5561 / Prot. 051091 / 2006

13

**“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË BRENDSHME TË DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË BURGJEVE”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ :

I. Miratimin e Rregullore së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri .

II. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Aldo Bumçi
Ministri Drejtësisë

Bumçi



RREGULLORJA E BRENDSHME

E

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME

TË

BURGJEVE

Miratuar me urdhrin e Ministrit Nr. 5561/13, Datë 05/09/2006

Tiranë 2006

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe objekti

1. Rregullorja e Brendshme është dokumenti bazë dhe i detyrueshme për zbatim nga e gjithë administrata e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.
2. Qëllimi i kësaj Rregulloreje të Brendshme është përcaktimi i organizimit, drejtimin dhe kontrollin e të gjithë veprimtarisë administrative të drejtorive, sektorëve, zyrave, specialisteve dhe punonjësve të tjerë në realizimin e detyrave, të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.
3. Për çështje të cilat nuk rregullohen shprehimisht nga kjo Rregullore, do të zbatohen aktet e tjera ligjore dhe nënligjore dhe legjislacioni përkatës.

Neni 2

Baza juridike e funksionimit dhe organizimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve

1. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është institucion në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë, sipas ligjit ndjek dhe realizon organizimin, drejtimin dhe kontrollin e të gjithë sistemit të ekzekutimit të vendimeve penale.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve funksionon në bazë të legjislacionit për shërbimin civil, ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim", ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", ligjit nr. 8321, datë 02.04.1998 "Për Policinë e Burgjeve", i ndryshuar, ligjit nr. 9397, datë 12.05.2005 "Për shërbimin e kontrollit të brendshëm".

Neni 3

Ministri i Drejtësisë

1. Ministri i Drejtësisë përcakton drejtimet kryesore të organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.
2. Ministri i Drejtësisë nxjerr aktet nënligjore për zbatim të bazës juridike të funksionimit dhe organizimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe kësaj rregulloreje dhe mbikëqyr zbatimin e tyre.

Neni 4
Parime të përgjithshme

1. Në kryerjen e detyrës, punonjësi i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve duhet të respektoj parimet si më poshtë:
 - a) Të njohë dhe të zbatoj legjislacionin për sistemin e burgjeve dhe rregulloren e brendshme të kësaj drejtorie. Personeli i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve mban përgjegjësi për moszbatimin e tyre.
 - b) Në kryerjen e detyrave duhet të jetë i ndershëm, i paanshëm, efikas, duke mbajtur parasysh vetëm interesin shtetëror;
 - c) Nuk duhet të veprojë arbitrarisht në dëm të një personi ose subjekti dhe duhet të tregoj respektin e duhur, për të drejta dhe interesat personale të të tretëve.
2. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve nxjerr rregulla në zbatim të parimeve të treguara në pikën 1 të këtij neni.

KREU II

**ORGANIZIMI ADMINISTRATIV DHE FUNKSIONIMI I DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË BURGJEVE**

Neni 5
Hierarkia në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve

Hierarkia e vartësisë në Drejtorinë të përgjithshme të Burgjeve është si më poshtë:

1. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.
2. Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.
3. Drejtorët e Drejtorive në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.
4. Përgjegjësit e Sektorëve.
5. Përgjegjësit e Zyrave.
6. Specialistët.

Neni 6
Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve

1. Drejtori Përgjithshëm i Burgjeve është funksionari më i lartë shtetëror i sistemit të burgjeve.
2. Drejtori Përgjithshëm i Burgjeve varet nga Ministri i Drejtësisë dhe raporton para tij për të gjitha problemet që lidhen me veprimtarinë e sistemit të burgjeve.
3. Drejtori Përgjithshëm i Burgjeve ka këto kompetenca:

- a) I Propozon Ministrit të Drejtësisë emërimin e Drejtorëve të Institucioneve të ekzekutimeve të vendimeve penale;
- b) Emëron të gjithë punonjësit e tjerë të këtyre institucioneve;
- c) Nxjerr urdhra dhe udhëzime, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga personeli i kësaj drejtorie;
- ç) Urdhëron lëvizjen dhe transferimin e të dënuarve në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale;
- d) Përgjigjet për gjendjen financiare dhe administrative të Drejtorisë së Përgjithshme dhe atyre vartëse;
- dh) Përgjigjet për kushtet e jetesës dhe trajtimet të dënuarve dhe të paraburgosurve në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe respektimin e të drejtave të tyre sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 7

Zëvendësdrejtori Përgjithshëm i Burgjeve

1. Zëvendësdrejtori Përgjithshëm i Burgjeve varet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe është përgjegjës për organizimin, drejtimin dhe kontrollin e punës në ato sektorë që i delegohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.

Neni 8

Drejtori Policisë së Burgjeve

1. Drejtori i Policisë së Burgjeve është funksionari më i lartë i Policisë së Burgjeve. Ai varet nga Drejtori Përgjithshëm i Burgjeve, dhe, drejton, organizon e kontrollon të gjithë veprimtarinë e Policisë së Burgjeve në sektorin e burgimit dhe paraburgimit, sektorin e transport shoqërimeve, sektorin e armatim municioneve, sektorin e ndërlidhjes, sektorin e informacionit dhe sektorin e përgatitjes.
2. Drejtori i Policisë së Burgjeve ndjek, kontrollon dhe përgjigjet për gjendjen e sigurisë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

Neni 9

Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Financës dhe Shërbimeve

1. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Financës dhe shërbimeve ushtron këto kompetenca:
 - a) Drejton dhe organizon veprimtarinë në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Sektorin e Financës, Sektorin e Supervizion-Kolaudimit, Sektorin e Administratës, Zyrën e Informatizimit dhe Zyrën e Arkiv –Protokollit;
 - b) realizon kontrollin ekonomik-financiar të strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale në vartësi të saj;

- c) Kontrollon respektimin e rregullave të brendshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, si dhe ndjek procedurat lidhur me marrjen e masave disiplinore ndaj nëpunësve civil dhe punonjësve ne kompetencë të Drejtorisë së Policisë;
- ç) Propozon sipas akteve ligjore, nënligjore dhe kësaj Rregulloreje marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës për shkeljen e disiplinës ekonomike dhe financiare;
- d) Kujdeset për mbajtjen, ruajtjen dhe përdorimin e arkivave;
- dh) Kryen detyra të tjera të caktuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.

Neni 10

Drejtoria Çështjeve Ligjore dhe Shoqërore

1. Drejtoria Çështjeve Ligjore dhe Shoqërore ushtron këto kompetenca:

- a) organizon dhe kontrollon veprimtarinë e Sektorit ligjor, Sektorit të Problemeve Shoqërore, Sektorit të Problemeve Shëndetësore, Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë dhe Shtypit dhe Zyrën e Kartotekës;
- b) ndjek dhe realizon të gjithë aktet në fushën juridike;
- c) kontrollon dhe organizon shërbimin shëndetësor të institucioneve në vartësi të saj;
- ç) merë masa për komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit me organet e shtypit dhe të medias;
- d) Kryen detyra të tjera të caktuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.

Neni 11

Drejtoria e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm

Drejtoria e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm ushtron veprimtarinë e saj në bazë të ligjit nr. 9397, datë 12.05.2005 “Për shërbimin e kontrollit të brendshëm”

Neni 12

Sektorët e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve

1. Sektorët në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve janë pjesë e strukturës organike të Drejtorisë së Përgjithshme. Sektorët varen nga drejtoritë përkatëse dhe përgjigjen për veprimtarinë e tyre.
2. Përgjegjësit e sektorëve bëjnë organizimin dhe janë përgjegjës për mbarëvajtjen punës në sektorët e tyre.
3. Përgjegjësit e Sektorit të Auditimit të Brendshëm, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm dhe Trajnimit të Personelit të burgjeve, varen nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dhe funksionojnë sipas dispozitave ligjore.

Neni 13

Specialistët e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve

Specialistët e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve ushtrojnë veprimtarinë e tyre sipas përshkrimit të vendit të punës sipas kësaj Rregulloreje dhe detyrave të tjera të ngarkuara nga eprorët e tyre.

Neni 14

Hierarkia funksionale

Në veprimtarinë e përditshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve zbatohet rigorozisht hierarkia funksionale e përcaktuar me strukturën organike.

Neni 15

Delegimi i kompetencave

Kur për shkaqe objektive realizimi i detyrave nuk mund të kryhet nga personi i ngarkuar drejtpërdrejt ose nuk ka zëvendësues të përcaktuar, eprori i tij, ia delegon kompetencat një personi tjetër zëvendësues.

KREU III

DETYRAT DHE TË DREJTAT E PUNONJËSVE

Neni 16

Detyrat funksionale të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve

Detyrat funksionale të gjithë punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve janë të përcaktuara në përshkrimet e vendit të punës dhe kontratat e punës për secilin prej tyre.

Neni 17

Ruajtja e sekretit shtetëror

Të gjithë punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve duhet të ruajnë dhe mos nxjerrin sekretin shtetëror.

Neni 18

Marrëdhëniet ndërmjet punonjësve

Marrëdhëniet ndërmjet punonjësve në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve bazohen në parimin e respektit reciprok dhe në ruajtjen e personalitetit të gjithsecilit .

Neni 19
Orari zyrtar

Orari zyrtar i punës është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga të gjithë punonjësit, për çdo rast të largimit nga institucioni për nevoja pune shtetërore ose familjare ndiqet praktika e përcaktuar në urdhrat që nxirren nga drejtuesi i institucionit.

Neni 20
Puna jashtë orarit zyrtar

Të gjithë punonjësit e institucionit janë të detyruar që për rastet kur është e nevojshme me urdhër të drejtorit përkatës, të dalin për të punuar dhe jashtë orarit zyrtar të punës dhe në ditë pushimi. Në këto raste bëhet pagesa sipas akteve ligjore në fuqi.

Neni 21
Paraqitja e punonjësve

Veshja dhe paraqitja e punonjësve duhet të jetë serioze, për ta përfaqësuar sa më denjësisht administratën shtetërore. Rregullat e hollësishme për veshjen dhe paraqitjen e punonjësve në institucion përcaktohen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 22
Komunikimi midis punonjësve

Në zyrat e institucionit, komunikimi i punonjësve me njëri-tjetrin duhet të jetë në përputhje të plotë me etikën morale e profesionale, pa përdorur fjalë fyese e denigruese, sidomos në marrëdhëniet epror vartës. Kjo natyrë komunikimi dhe sjellje duhet të jetë dhe në marrëdhënie me punonjësit e institucioneve të tjera dhe qytetarët.

Neni 23
Mungesa në punë

Për çdo rast të mungesës në punë për arsye të ndryshme, punonjësit duhet të njoftojnë menjëherë eprorin e drejtpërdrejtë dhe të paraqesin sa më parë dokumentacionin përkatës në drejtori kur e disponojnë atë.

Neni 24
Rregullat e sjelljes

Ndalohej pranimi i ndereve, dhuratave e ofertave të ndryshme për të gjithë punonjësit, që kanë të bëjnë me ushtrimin e punës së gjithsecilit punonjës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Neni 25
Detyrime të punonjësve

Punonjësi i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve i ndalohej të konsumoj pije alkoolike në mjediset e institucionit dhe jashtë institucionit brenda orarit zyrtar, ndalohej pirja e duhanit në zyrat e institucionit.

Neni 26
Veprimtaritë e jashtme

Punonjësi i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nuk duhet të angazhohet në një veprimtari të jashtme, që pengon kryerjen e detyrës së tij zyrtare ose që kërkon një angazhim, mendor a fizik të tij, që e bën të vështirë kryerjen e detyrës, ose që cenon, në çdo mënyrë imazhin e punonjësit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Neni 27
Kërkesa dhe ankesa

Punonjësit e drejtorisë kanë të drejtë të paraqesin kërkesa dhe ankesa lidhur me veprimtarinë e tyre në organ sipas shkallës hierarkike.

Neni 28
Trajnime të detyrueshme

Të gjithë punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve janë të detyruar të marrin pjesë në trajnime të ndryshme që organizohen për ngritjen e tyre të vazhdueshme tekniko-profesionale.

Neni 29
Shmangia e konfliktit të interesave

1. Punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme duhet të shmangin konfliktin e interesave që ndikon në mbarëvajtjen dhe kryerjen e rregullt të detyrës dhe në çdo rast të krijimit të tij të njoftojnë menjëherë drejtuesin e institucionit.

2. Shmangia e konfliktit të interesave bëhet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, si dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 30

Prononcimi për shtyp

1. Ndalohet prononcimi i punonjësve të drejtorisë në mediat e shkruara dhe ato vizive, pa dijeninë e titullarit për probleme që kanë të bëjnë me organizimin dhe veprimtarinë e këtij institucioni dhe sigurinë në burgje.
2. Të ruajë konfidencialitetin e informacionit, që ka në zotërim, por pa cenuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 31

Dispozita zbatuese

1. Struktura e personelit është e detyruar t'i bëj të ditur nëpunësit në çastin e punësimit të tij detyrimet që rrjedhin nga ky ligj dhe që duhen respektuar nga punonjësi i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.
2. Punonjësi ka për detyrë të sillet në përputhje më këtë Rregullore dhe aktet ligjore dhe nënligjore dhe, për këtë arsye, informohet për çdo ndryshim ose shtesë në këto akte.
3. Shkelja e dispozitave të Rregullores dhe akteve ligjore dhe nënligjore bëhet shkak për marrjen e masave disiplinore.

Neni 32

Masat disiplinore

1. Emërimi, shkarkimi dhe dhënia e masave disiplinore i të gjithë nëpunësve civil të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Emërimi, shkarkimi dhe dhënia e masave disiplinore për shërbimin policor në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve bëhet në bazë të ligjit Nr. 8321, datë 02.04.1998, i ndryshuar dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore.
3. Emërimi, shkarkimi dhe dhënia e masave disiplinore i të gjithë punonjësve të tjerë që nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil, bëhet në bazë të Kodit të Punës dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 33
Detyrim për zbatim

Të gjithë urdhrat dhe udhëzimet e nxjerra nga titullari i organit dhe eprorët janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga vartësit.
Shkelja dhe moszbatimi i tyre në afat, përbën shkak për marrjen e masave disiplinore.

Neni 34
Shfuqizim

Rregullorja e Brendshme e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, miratuar me Urdhrin Nr. 4595, datë 15.07.2003 shfuqizohet.

Neni 35
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi me miratimin e saj.